

Prot. 2211/225 K (e-k)

Datë, 22/11/2022, Tiranë

Lënda: *Partia Aleanca Demokracia e Re*

Gjetjet nga monitorimi i KRIIK mbi aktivitetin dhe raportimin

financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2021!

Përshëndetje,

Në zbatim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t'ua përcjellë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike si dhe duke përjashtuar gjetjet që tashmë janë përfshirë në raportin e përgatitur nga KQZ-ja, ju ridërgojmë në formë të përmbledhur dhe të personalizuar se *lidhur me subjektin ADR, KRIIK ka konstatuar se:*

- *evidentohet një numër prej 2 zyresh zgjedhore të padeklaruar;*
- *2 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ;*
- *mungon bilanci i asetëve dhe detyrimeve.*

Lidhur me numrin e zyrave zgjedhore

Nga monitorimi i bërë prej vëzhguesve të KRIIK rezultojnë 2 zyra zgjedhore të hapura nga ky subjekt. Nga raportet e monitoruesve të KQZ-së rezultojnë 0 zyra zgjedhore të hapura nga ky subjekt. Në raportin e vetëdeklarimit ky subjekt ka deklaruar 0 zyra zgjedhore të hapura për zgjedhjet e datës 25 prill 2021.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen koordinatat e vendndodhjes, brandimi ose jo me emër kandidati i zyrës zgjedhore, si dhe fotot përkatëse.

Vendndodhja	Bashkia	Partia	Kandidati/ja	Foto
41.3161704, 19.4477287	Durrës	ADR - Partia Aleanca Demokracia e Re	Stefan Strazimiri	https://drive.google.com/file/d/1jxVceWeRR5vYokZrd6_Elqh79b1gJvS/view?usp=share_link
41.775825, 19.65188	Lezhë	ADR - Partia Aleanca Demokracia e Re	Eduart Ndocaj	https://drive.google.com/file/d/17VniOD5W153z_DI7ojVlhcZjz3BL5sMi/view?usp=share_link

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lidhur me shpenzimet e kandidatëve të ADR për reklamë politike në Facebook dhe Instagram

Dy kandidatë të ADR z. Edmond Stojku dhe z. Gledi Kryemadhi, për faqen në *Facebook* të të cilëve janë paguar shuma të cilat janë të pamundura për t'u indentifikuar saktësisht për shkak se në secilin nga rastet janë më të vogla se 100\$, nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ.

Lidhur me bilancin e aseteve dhe detyrimeve

Sipas komunikimit shkresor me KQZ-në rezulton se ADR nuk ka dorëzuar bilancin e aseteve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve (pra nga data 6 shtator 2020 – 25 prill 2021), në zbatim dhe kuptim të detyrimit ligjor sipas nenit 92/3 “*Deklarimi dhe publikimi*” pika ç të Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu, lidhur me shkeljet e trajtuara në Raportin e përgatitur nga KQZ-ja, sjellim në vëmendje se nga monitorimi i KRIIK rezulton se *Partia ADR, ka depozituar në KQZ raportin e vetëdeklarimit të partisë dhe asnjë raport të kandidatëve të saj të përfshirë në listat shumëëmërore.*

Ky subjekt nuk është përfshirë në raportin e KQZ-së si subjekt që ka bërë dorëzim të një raporti jashtë formateve të standartizuara, sikurse është vepruar me partitë e tjera të cilat kanë të njëjtën shkelje.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

Me konsideratë,

**Për Koalicionin Për Reformë, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

Premto Gogo

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania